



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 269, Datë 14.10.2022

MBI

**RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 249, DATË 13.12.2021 “MBI RISHIKIMIN E
VENDIMIT NR. 111, DATË 26.04.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “E-VENTO
S.R.L ALBANIA” SH.P.K., PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S
NR. 32, DATË 04.02.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “E-VENTO S.R.L
ALBANIA” SH.P.K., PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 84, DATË
17.07.2008, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2 dhe 3 dhe nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1799/9 prot., datë 12.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rishikimin e vendimit nr. 249, datë 13.12.2021 “Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-VENTO S.R.L ALBANIA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-VENTO S.R.L ALBANIA” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 249, datë 13.12.2021, vendosi:

1. Të zgjasë me 12 (dymbëdhjetë) muaj afatin e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 3.1 (Studimi i Fizibilitetit), të Vendimit nr. 111, datë 26.04.2021.
2. Të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 3.2 dhe pikën 4, gërmat “a” dhe “b” (leja e mjedisit, dokumentacioni pronësor dhe dokumentacioni përkatës vërtetues për realizimin e investimeve), të Vendimit nr. 111, datë 26.04.2021.
3. Shoqëria “E-VENTO s.r.l. ALBANIA” sh.p.k. të informojë/dokumentojë në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimit të këtyre kushteve.

4. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë në përputhje me informacionin/dokumentacionin e përditësuar sipas pikës 3, të këtij vendimi, apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet e tjera.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 249/2021 me shkresën nr. 961/14 prot., datë 29.12.2021 dhe me shkresën nr. 167 prot., datë 24.01.2022, i kujtoi shoqërisë detyrimin për të informuar/dokumentuar në ERE ecurinë e plotësimit të kushteve të këtij vendimi.
- Në vijim dhe në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 249/2021, shoqëria me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 167/1 prot., datë 25.01.2022, nr. 167/2 prot. datë 23.03.2022, nr. 167/5 prot., datë 13.06.2022, nr. 167/6 prot., datë 05.07.2022, 1360 prot., datë 21.07.2022, nr. 167/7 prot., datë 01.08.2022, nr. 167/8 prot., datë 12.08.2022, nr. 167/9 prot., datë 29.08.2022, nr. 167/11 prot., datë 14.09.2022, si dhe nr. 167/12 prot., datë 21.09.2022, ka depozituar dokumentacion, nga i cili rezulton si më poshtë.
- Përsa i përket pajisjes me *Lejen e Mjedisit*, shoqëria ka bërë me dije, se pas pajisjes me VNM Paraprake, për shkak të kompleksitetit të projektit dhe shtrirjes së madhe të tij, duhet t'i nënshtrohet procedurës për VNM-në e thelluar, për t'u pajisur me Deklaratë Mjedisore. Shoqëria ka dokumentuar në ERE realizimin e Raportit të Thelluar të ndikimit në mjedis. Në vijim shoqëria ka bërë me dije se ka bërë dhe aplikimin përaktës për t'u pajisur me këtë deklaratë.
- **Sa më sipër rezulton se shoqëria "E-VENTO srl ALBANIA" sh.p.k. nuk e ka plotësuar ende këtë kusht, por është në proces për t'u pajisur me Deklaratën Mjedisore përkatëse.**
- Përsa i përket *dokumentacionit pronësor*, shoqëria ka njoftuar se sipërfaqja e pronave e azhornuar nga shoqëria, është dorëzuar pranë bashkive për t'u konfirmuar.
- **Sa konstatuar, në Udhëzimin nr. 1/2016, konkretisht pika 10, gërma "h", përcaktohet se, pjesë e dokumentacionit për të marrë në përdorim një sipërfaqe të caktuar nga fondi pyjor kullosor publik është dhe leja mjedisore. Sa më sipër, për të vijuar me plotësimin e këtij kushti, shoqëria "E-VENTO srl ALBANIA" sh.p.k. duhet të pajiset fillimisht me Deklaratën Mjedisore.**
- Përsa i përket *realizimit të investimeve për zhvillimin e projektit*, shoqëria ka depozituar një marrëveshje investimi ndërmjet saj dhe shoqërisë "G.P.G COMPANY" sh.p.k. me objekt bashkëpunimin mes dy shoqërive për të mundësuar realizimin e projektit të ndërtimit të parkut eolik, ku shoqëria "G.P.G COMPANY" sh.p.k. merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet e nevojshme të paraqitura për realizimin e projektit
- Gjatë raportimeve të saj periodike, referuar dhe vonesave të shkaktuara përtej vullnetit të shoqërisë, kjo e fundit ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 249/2021 me 6 muaj.
- Duke marrë në konsideratë përpjekjet e saj për të plotësuar kushtet e vendimit nr. 249/2021, raportimet periodike, ku janë pasqyruar e dokumentuar vonesa që nuk varen nga shoqëria për sa i përket pajisjes me Deklaratën Mjedisore, si dhe faktit që rinovimi apo lidhja e kontratave

të qirasë varet nga marrja e Deklaratës, vlerësohet të zgjaten afatet e plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 2 të vendimit nr. 249/2021.

- Gjithashtu, në kuadër të vlerësimit të përpjekjeve të shoqërisë në plotësim të këtyre kushteve, vlerësohet që t'i lihet asaj detyrimi për të depozituar në ERE, një progres raport me informacione çdo 3 (tre) muaj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit nr. 249, datë 13.12.2021 ndryshon si vijon:
2. Të zgjasë me 3 (tre) muaj afatin e depozitimit të Deklaratës Mjedisore dhe me 6 (gjashtë) muaj afatin e depozitimit të dokumentacionit pronësor duke filluar ky afat nga data 14.09.2022.
2. Pika 3 e vendimit nr. 249, datë 13.12.2021 ndryshon si vijon:
3. Shoqëria “E-VENTO s.r.l. ALBANIA” sh.p.k. çdo 3 (tre) muaj një progres raport me informacion për investimet që do të kryejë, në kuadër të plotësimit të kushteve të sipërcituara.
3. Shoqëria “E-VENTO s.r.l. ALBANIA” sh.p.k. të paraqesë në ERE në mënyrë periodike me data të rifreskuara dokumentet që i nënshkrohen rinovimit të afateve.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI